




Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	29	10	2020	0	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	SKPMŠHCK	Nr Prot Br Prot Prot No	2364/2020	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
					113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.268/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.268/2020 të datës 15/09/2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Arsim Bilalli me adresë rruga “Sheshi Edit Durham”, nr.3, kati I, hyrja nr.2 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.95/2020 të datës 17/08/2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29/10/2020, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.95/2020 i datës 17/08/2020 i Zv.Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë rishqyrtimin e rastit të ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] fillimisht me Vendimin e datës 20/07/2011 është emëruar zëvendës konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Riad, ndërsa me Dekretin të datës 17/07/2013 është emëruar Ambasador rezident i Republikës së Kosovës në Republikën Arabe të Egjiptit. Në bazë të Vendimit me Nr. 338/2026 të datës 13/06/2020 ankuesi tërhiqet nga misioni diplomatik, ku me Vendimin me Numër 157/2016 të datës 09/12/2026 caktohet në pozitën “Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë Diplomatike” të cilën pozitë e

ka mbajtur me Akt Emërim deri më datë 01/07/2019 kur është dërguar në mision diplomatik në Riad, ndërsa në bazë të Vendimit të datës 31/10/2019 tërhiqet nga misioni diplomatik, duke u caktuar në pozitën “Drejtor i Departamentit për Çështje Konsullore” të cilën pozitë e ka mbajtur deri më datë 17/08/2020 ku sipas Vendimit me Nr. 95/2020 është sistemuar në mënyrë të përkohshme në pozitën “Udhëheqës i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim” në Akademinë Diplomatike.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 95/2020 të datës 17/08/2020 të z.v. Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, më datë 15/09/2020 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1761/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21/09/2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 28/09/2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1761/2020 të datës 15/09/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim; Dekretin e datës 17/07/2013 të Presidentes së Republikës së Kosovës; Vendim me Numër 35/2017 i datës 07/02/2017; Vendimin me Numër 129/2019 i datës 01/11/2019; Akt Emërimin e datës 09/12/2016; Vendimin me Numër 459/2019 i datës 31/10/2019; Vendimin me Nr. 95/2020 i datës 17/08/2020; E-maili i datës 21/07/2020 nga Afërdita G. Krasniqi për Shkelzen Morina; Vendimin e datës 20/07/2011 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr. 338/2016 i datës 12/08/2016; Vendimin me Nr. 157/2016 i datës 09/12/2016; Vendimin me Nr. Ref. 305/2019 i datës 01/07/2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim në Akademinë Diplomatike i datës 17/04/2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Konsullore dhe Përgjigjen në ankesë e datës 28/09/2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar lëndën e ankuesit ka konstatuar se ekziston baza ligjore që rasti i ankuesit të kthehet në *rishqyrtim* duke e obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që rastin e ankuesit [REDACTED] [REDACTED] ta trajtoj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës Vendimin me Nr. 95/2019 të datës 17/08/2020 për sistemimin e përkohshëm të ankuesit [REDACTED] nga pozita “Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore” në pozitën “Drejtor i Drejtoratit për Trajnime dhe Zhvillim” në Akademinë Diplomatike e ka nxjerr duke u bazuar në dispozitat e nenit 4 pikës 2.5 dhe nenit 52 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, mirëpo në bazë të këtij vendimi zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka specifikuar saktë kohën se sa do të zgjasë transferimi i përkohshëm i ankuesit siç parashihet me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, i cili përcakton: **“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve dhe 1.2 për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve”**, sepse në bazë të legjislacionit duhet të përcaktohet kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm, po ashtu nuk janë dhënë arsye se cilat janë rrethanat që i kanë paraprijë transferimit të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. 95/2019 i datës 17/08/2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk përmban as elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj kjo ka shkaktuar edhe pasiguri juridike tek ankuesi sepse i njëjti vendim nuk ka asnjë arsyetim dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: **“Një arsyetim që është dukshëm i**

pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”, Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit”*, siç parashihet me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, kështu që duke marr parasysh dispozitat ligjore të lartcekura Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i obliguar të rishqyrtoj rastin e transferimit të ankuesit dhe të njëjtin ta bëjë në pajtim me legjislacionin në fuqi..

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.268/2020

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokatit Arsim Bilalli;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

